



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 115, datë 31.08.2020

PËR

**MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ZJ. ANILA HOXHA SI
DREJTOR EKZEKUTIV TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMEVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 43, pika 2, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, neneve 17 dhe 20 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/ shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/ mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riemërimit të zj. Anila Hoxha, si Drejtor Ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve për një periudhë 1-vjeçare.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE